



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 31

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 13 gusht 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 3995, datë 3.8.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “FRENKI sh.p.k.”..... 3
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 897/9, datë 7.8.2018	Për shprehje interesi, për shërbimin e konsulencës “Hartimi i metodologjive dhe trajnimi i stafit për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e një profili të rrezikut (përfshirë procedurat ndërkontrolluese) për NE-në”, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale..... 6
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 897/10, datë 7.8.2018	Për shprehje interesi, për shërbimin e konsulencës “Ekspert lokal prokurimi”, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale..... 9
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 5724, datë 9.8.2018	Për pozicionin e lirë të Sekretarit të Përgjithshëm në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit..... 12

**KËRKESË****Nr. 3995, datë 3.8.2018**

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “FRENKI” SHPK**

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Qendër, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për autorizimin e inspektimit, me nr. serie 0002437, datë 20.7.2018; procesverbalin e inspektimit, me nr. serie 0001717, datë 20.7.2018 dhe aneksin e procesverbalit të inspektimit, datë 20.7.2018, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi ISHMPUT-së, duke u konfirmuar adresë jo e saktë.

Sa më sipër, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Qendër, bën njoftimin publik të akteve respektivisht për subjektin “FRENKI” sh.p.k.

Bashkëlidhur, autorizimi i inspektimit, me nr. serie 0002437, datë 20.7.2018; procesverbalin e inspektimit, me nr. serie 0001717, datë 20.7.2018 dhe aneksi i procesverbalit të inspektimit, datë 20.7.2018

**KRYEINSPEKTOR
I NGARKUAR NË DETYRË
Armando Lamaj**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE
AUTORIZIM INSPEKTIMI**

Nr. Serial: 0002437 **Datë:** 20.7.2018

Në zbatim të nenit 27, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 103, datë 04.02.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave” të ndryshuar, të Këshilit të Ministrave, lëshohet ky autorizim inspektimi, për sa vijon:

Të dhëna mbi subjektin e inspektimit:

Emri i subjektit: FRENKI sh.p.k **NIPT:** K221270032

Adresa: Krautë, Fushë Krrajë, Selia Dajit Tiranë
Linë, Reshtakë

Përshkrim i objektit të inspektimit:
Inspektim rregullor për përputhshmërinë me legjislacionin mjedisor për shpërndarjen dhe funksionimin e gaut gjepor.

Inspektorët shtetërorë të ISHMPU, të autorizuar për të kryer inspektimin:

1. Genti Haderaj ID: 0300020011 ;

2. Adnan Seferaj ID: 0300020004 ;

3. _____ ID: _____ ;

Kohëzgjatja e inspektimit: 1 ditë në datë: 20.7.2018

Njoftim paraprak i autorizimit subjektit të inspektimit është dërguar: Po → _____ ; Jo → + ;

Njoftimi paraprak i autorizimit nuk njoftohet referuar gërmës (d) të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, për arsye:

“ Aktiviteti është identifikuar me parë. ”

KRYEINSPEKTORI

Ky akt mbahet në 4 kopje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE

Nr. Serial: **0001717**

Datë: **20 / 7 / 2018**

PROÇES - VERBALI I INSPEKTIMIT

Në zbatim të nenit 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave", të ndryshuar, në kontrollin e ushtruar në subjektin:

FRENKI SH.PK

NIPT: **K2212F003R**

Aktiviteti dhe adresa e subjektit: **Shfrytëzim dhe funksionim i gurit gëlqeror. Krahë: Krahë, Shqipëri: Dajt Tiranë, Linze Desart.**
 në prani të: _____, me detyrë _____

Konstatova: Subjekti është mbajtës i një leje administrative: Po → ☐ Jo → ☐ ;

Tipi i Lejes Mjedisore _____, Nr. Identifikimit _____, datë ____ / ____ / ____.

PËRSHKRIMI, GJETJET DHE SHKELJET ADMINISTRATIVE:

Në bazë të autorizimit të inspektorit rastësor me nr. 0002437 datë: 20.7.2018 dhe inspektorit të kryer rezultati të: Subjekti zhvillon aktivitetin e shfrytëzimit dhe funksionimit të gurit gëlqeror. Duke qenë se referencat konstatohen ndryshe Subjekti Hava-Shpk, verifikimit dhe jeteve në tërësi subjekti Fremki Shpk zhvillon aktivitetin me lejeve

**Personi përgjegjës
i kontrolluar**

Specialisti

Inspektori i ISHMPU

Nat. e pasqit
 (Emër, mbiemër, firmë)
në aktivitet

 (Emër, mbiemër, firmë)

Grandi Haderop Hly
Dritan Shkripa
 (Emër, mbiemër, firmë)

• Akti inspektimit mbahet në 4 (katër) kopje dhe sipas qëllimit të inspektimit përdoret:

- | | |
|---|--|
| 1. Për kontrollin e përputhshmërisë. ☐ | 3. Për inspektim të rastësishëm. ☒ |
| 2. Për verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna. ☐ | 4. Për rast incidenti ose aksidenti. ☐ |

• Për përshkrime të detajuara, aktit të inspektimit i bashkëlidhet një aneks shtesë A-4, si pjesë e tij.





Datë 20/7/2018

Aneks

Nr.serie 0001714

Proces – Verbal Inspektimi

Shfrytëzimit të qurit gëlqeror të subjektit
Arvo-shpk dhe nuk e ka transferuar qte.

Hja verifikimi me sistemin elektronik të QKB
rezulton se subjekti Fremka Shpk zhvillon
aktivitetin e funksionimit të qurit gëlqeror
pa leje mjedisore.

Subjekti duket të parqese brenda datës: 20.7.2018
pranë zyrave të ISHMPU.

- 1- Lefem Mjedisore për impiantin e funksionimit
të qurit gëlqeror.
- 2- Raportet e monitorimit për të gjithë aktivitetin.
- 3- Dokumentacionin për zbatimin e kushteve
të lejes mjedisore.

Pas kalimit të këtij afati vendimi përfundimtar
do të merret pa qenë i nevojshëm degjimi
i metejshëm i subjektit të inspektimit.

Personi përgjegjës
i kontrolluar.

Inspektoret e ISHMPU

Nut u paragit.
(Emër, mbiemër, firmë)
në aktivitet.

Geniti Haderaj
Dritan Sejdiu
(Emër, mbiemër, firmë)



KËRKESË

Nr. 897/9, datë 7.8.2018

**PËR SHPREHJE INTERESI,
PËR SHËRBIMIN E KONSULENCËS
“HARTIMI I METODOLOGJIVE DHE
TRAJNIMI I STAFIT PËR NDËRTIMIN,
MIRËMBAJTJEN DHE PËRDITËSIMIN E
NJË PROFILI TË RREZIKUT
(PËRFSHIRË PROCEDURAT
NDËRKONTROLLUESE) PËR NE-në”,
PËRFITUES I SË CILËS ËSHTË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
NUMËR REFERENCE:
SAMP/CS/CQ/07-2016**

*Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)
Hua nr. 8141-AL*

Nr. i identifikimit të projektit: P122233

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar ta përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës lokale (shërbimi) përfshin: **“Hartimin e metodologjive dhe trajnimin e stafit për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e një profili të rrezikut (përfshirë procedurat ndërkontrolluese) për NE-në”**.

Qëllimi i kësaj detyre është të hartojë dhe të zbatojë një sistem hetimi me bazë rrezikun me mbështetjen e SMI-së për NE-në, të integrojë masat korrigjuese të sistemit për mashtrim dhe gabim dhe të përgatisë udhëzimet operacionale që përshkruajnë një sistem referimi për rastet e gabimit ose të dyshimit për mashtrim dhe korrupsion, me kanale të qarta raportimi për stafin dhe publikun e gjerë dhe të ofrojë trajnimin e inspektorëve socialë për metodologjitë për ndërtimin, mbajtjen dhe azhurnimin e profilit të rrezikut për NE-në.

Në këtë kontekst, një firmë konsulente do të rekrutohet për të ndihmuar MHSP-në për të hartuar dhe për të zbatuar një sistem hetimi me bazë rrezikun me mbështetjen e SMI-së për NE-në, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe saktësisë së zbulimit të mashtrimit dhe gabimeve.

Kompania do të jetë përgjegjëse, për:

- Analizën e sistemeve të zgjeruara të informacionit të automatizuar të NE-së, përfshi

përdorimin e mjeteve të profilizimit, me bazë rreziku në formulimin e kornizës dhe të politikave. Përfshirjen në kuadrin ligjor të sanksioneve të forcuara me mjete të qarta hetimi, sanksioneve dhe dispozitave për rastet e mashtrimit dhe të gabimit, si dhe për pasojat e llojeve të ndryshme të mashtrimit dhe të gabimit;

- Përgatitjen dhe zhvillimin e kuadrit ligjor përkatës, të nevojshëm për përdorimin në inspektim të mjeteve të profilit të bazuar në rrezik, duke përfshirë shënimet shpjeguese, si dhe tabelën e përputhshmërisë së akteve të hartuara me *acquis communautaire*, nëse është e nevojshme;

- Zhvillimin e një mjeti profilizimi me bazë risku për inspektimet sociale të rasteve të NE-së;

- Aplikimin dhe testimin e mjetit për të vërtetuar saktësinë e tij në identifikimin e rasteve me rrezik të lartë;

- Përgatitjen e udhëzimeve operacionale që përshkruajnë si të aplikojnë mjetin e profilizuar me bazë rreziku dhe një sistem referimi për rastet e gabimit ose dyshimit e mashtrimit dhe të korrupsionit, me kanale të qarta raportimi për stafin dhe publikun e gjerë;

- Zhvillimin e moduleve të nevojshme për ofrimin e trajnimeve për stafin e dedikuar për metodologjitë për ndërtimin, mbajtjen dhe përditësimin e profilit të rrezikut për NE-në;

- Zhvillimin e modelit të raporteve të profilizimit të rrezikut që duhet të gjenerojë sistemi i menaxhimit të informacionit SMI;

- Ofrimin e trajnimit të inspektorëve socialë për metodologjitë për ndërtimin, mbajtjen dhe përditësimin e profilit të rrezikut për NE-në.

Ky shërbim do të kërkojë një firmë konsulente me njohuri solide të praktikave më të mira lokale në sektorin social. Konsulenti duhet të dëshmojë kryerjen me sukses të shërbimeve të ngjashme.

Konsulenti duhet të ketë një ekip shumëdisiplinor, me përvojë dhe njohuri të konsiderueshme për mbrojtjen sociale, veçanërisht për programin e NE-së dhe njohuri bazë solide të zhvillimit procedural, institucional dhe shoqëror në përgjithësi.

Konsulenti pritët të ketë përvojë në hartimin dhe zbatimin e procesit të inspektimit të programeve të sektorit social, brenda 5 viteve të fundit. Ky shërbim kërkon një ekip të përbërë, së paku nga një ekspert social, ekspert statistikash dhe ekspert ligjor.



Kompania duhet të demonstrojë ekspertizë dhe aftësi në fushat e mëposhtme:

- Vlerësime në fushën sociale;
- Inspektimi në fushën sociale;
- Çështjet operative dhe çështjet administrative të asistencës sociale;
- Forcimi organizativ dhe institucional;
- Komunikim.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP) fton kompanitë konsulente (konsulente) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimit të kërkuar. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet.

Kriteret e shortlistimit janë:

Kriteret e shortlistimit	Pikët
Eksperiencia e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e shërbimit	30 pikë
Numri i kontratave që kanë lidhje me shërbimin, të përfunduara gjatë tri viteve të fundit.	20 pikë
Eksperiencia e përgjithshme dhe kualifikimet e stafit kryesor	20 pikë
Eksperiencia specifike në fushën e shërbimit dhe kualifikimet e stafit kryesor	30 pikë
TOTALI	100 pikë

Shërbimi do të kryhet nga një kompani konsulente. Metoda e përzgjedhjes do të jetë: Kualifikimet e konsulentëve (CQ), në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzuesit e Bankës Botërore: *Përzgjedhja e punësimit i Konsulentëve të Bankës Botërore (botimi 2011) (edition of 2011)*.

Shërbimi pritët të fillojë në shtator 2018 dhe të përfundojë në dhjetor 2018.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00–16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me e-mail) deri më **21 gusht 2018**

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Rruga e Kavajës, AL-1001, Tirana, Albania
Në vëmendje të znj. Suzana Papadhopulli
e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

REQUEST FOR EXPRESSION OF INTEREST CONSULTING SERVICES FOR

“Design of methodologies and delivery of training for building, maintaining and updating a risk profile (including cross-checking procedures) for NE”
- Ref. no. SAMP/CS/CQ/07-2016

Albania

Social Assistance Modernization Project (SAMP)

Loan No.: 8141- AL

Project ID No. P122233

The Republic of Albania, has received financing from the World Bank toward the cost of the Social Assistance Modernization Project (SAMP), and intends to apply part of the proceeds for consultant services. The consulting services (“the Services”) include **“Design of methodologies and delivery of training for building, maintaining and updating a risk profile (including cross-checking procedures) for NE”**.

The objective of this assignment is to design and implement a risk based investigation system with the support of MIS for NE, to integrate into the system corrective measures for fraud and error and to prepare the Operational Guidelines that describe a referral system for cases of error, or suspicion of fraud and corruption, with clear reporting channels for staff and the general public and to deliver the training of social inspectors on methodologies for building, maintaining and updating a risk profile for NE.

In this context a consultant firm will be recruited to assist the MHSP to design and implement a risk-based investigation system with the support of MIS for NE in order to enhance efficiency and accuracy of detection of fraud and errors.

The consultant firm will be responsible for:

- Analyze the enhanced automated information systems of NE, and include use of risk based profiling tools in the policy and framework formulation. Include strengthened sanctions policy with explicit investigation remedy, sanction and enforcement provisions for fraud and error both in



the legislative framework for consequences of different types of fraud and error.

- Prepare and develop the relevant legislative framework as necessary for using risk-based profiling tool in inspection, including explanatory notes as well as the compatibility table of the designed acts with the *acquets communautaire* if necessary.

- Develop a risk-based profiling tool for social inspections of NE cases.

- Applying and test the tool to validate its accuracy in identifying high-risk cases;

- Preparing the Operational Guidelines that describe how to apply the risk-based profiling tool and a referral system for cases of error, or suspicion of fraud and corruption, with clear reporting channels for staff and the general public;

- Develop modules needed for delivering training to the dedicated staff on methodologies for building, maintaining and updating a risk profile for NE;

- Develop template of Risk profiling reports that MIS should generate;

- Deliver the training of social inspectors on methodologies for building, maintaining and updating a risk profile for NE.

This assignment will require a Consultant firm with a solid knowledge of local best practice in social sector. The Consultant must have proved track record in undertaking similar assignments. It must have a multi-disciplinary team, which has significant experience in and familiarity with social protection, especially with NE program and solid base understanding of procedural, institutional and social development in general.

The Consultant is expected to have experience in the design and implementation of the inspection process of social area programs within the last 5 years. This service requires a team consisting at least of a Social Expert, Statistician Expert and Legal Expert.

The company must demonstrate expertise and skills in the following areas:

- Assessments and evaluation in social field;
- Inspection in social field;
- Social Assistance operational issues and social assistance administrative issues;
- Organizational and institutional strengthening;
- Communication;

The Ministry of Health and Social Protection through Project Management Team (PMT) now invites eligible local consultant firms (“Consultants”) to indicate their interest in providing the Service required. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The Consultant will be selected taking into consideration the following short listing criterion:

Short listing Criterion	Points
Overall experience of the firm (number of years) in the field of assignment	30 points
Number of assignment-related contracts completed during last three years	20 points
General experience and qualification of the key personnel	20 points
Assignment-relevant experience and qualification of key personnel	30 points
TOTAL	100 points

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank’s Guidelines: *Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers* (“Consultant Guidelines”) - January 2011, setting forth the World Bank’s policy on conflict of interest.

The assignment will be implemented by a Consultant Firm. The selection method to be applied is Consultants Qualification Selection (CQ), in accordance with the procedures set out the World Bank’s *Guidelines: Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers* (edition of 2011).

The consultant is expected to start the service on September 2018 and to complete it by December 2018.

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by fax, or by *e-mail*) by **August 21, 2018**



**Project Management Team (PMT)
Social Assistance Modernization Project
(SAMP)**

**Ministry of Health and Social Protection
Rruga e Kavajës, AL-1001, Tirana, Albania
Att: Suzana Papadhopulli
e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com**

KËRKESË

Nr. 897/10, datë 7.8.2018

**PËR SHPREHJE INTERESI, PËR
SHËRBIMIN E KONSULENCËS
“EKSPERT LOKAL PROKURIM”,
PËRFITUES I SË CILËS ËSHTË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
KONSULENT INDIVIDUAL LOKAL
REF. NO. SAMP/CS/IC/03-2017-D**

*Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)
Hua nr. 8141-AL*

Nr. i identifikimit të projektit: P122233

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar ta përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (shërbimi) së kërkuar është “**Ekspert lokal prokurim**”.

Konsulenti i prokurimit do të jetë përgjegjës për të siguruar se mallrat dhe shërbimet e konsulencës nën komponentin e dytë të Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) do të prokurohen në përputhje me udhëzimet e prokurimeve dhe të konsulencës së Bankës Botërore (janar 2011).

Ekspert i prokurimit është përgjegjës, për:

- Punon me grupet teknike të interesuara në përgatitjen e termave të referencës për kontratat që do të prokurohen, kryesisht nën komponentin 2 të projektit, në përputhje me metodat e ndryshme të përzgjedhjes, të përcaktuara në planin e prokurimit;
- Ndhmon grupet përkatëse teknike të punës dhe komisionet e vlerësimit në vlerësimin e propozimit të marrë, në bazë të kriterëve të përcaktuara në dokumentet e ofertimit ose në kërkesën për propozime;
- Punon drejtpërdrejt dhe ndihmon stafin e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe stafit të MHSP-së, për çdo çështje të prokurimit gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit;

- Siguron përgatitjen e raporteve gjithëpërfshirëse të vlerësimit sipas formateve standarde të Bankës Botërore dhe transmetimi në kohë i raporteve të vlerësimit për Bankën Botërore për shqyrtim dhe miratim;

- Ngre dhe mban një sistem efikas ndjekjeje të prokurimit dhe të kontraktimit (duke përmendur datat e rëndësishme të miratimit, fituesit, shumat e kontratës etj.), si dhe një sistem të përshtatshëm të të dhënave për të siguruar marrjen e shpejtë të informacionit të prokurimit nga stafi i projektit, misionet mbikëqyrëse, auditorët vjetorë etj.;

- Përgatitja dhe dorëzimi i menaxherit të EMP-së i raporteve periodike të prokurimit që përshkruajnë procedurat e prokurimit për zbatimin e aktiviteteve të projektit, në përputhje me planin dhe identifikimin e çështjeve të prokurimit që lindin gjatë zbatimit të projektit dhe zgjidhjeve të propozuara;

- Përgatitja dhe publikimi i njoftimeve të prokurimit;

- Përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe kërkesave për propozim;

- Përgatitja e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për hapjen e ofertave, sqarimet, ndryshimet, vlerësimet dhe dhënia e kontratës;

- Të dorëzojë kontratat e negociuara në bankë për kontratat që janë subjekt i shqyrtimit paraprak të bankës;

- Përgatitja dhe azhurnimi i planeve të prokurimit dhe sigurimi i zbatimit në kohë i paketave të prokurimit;

- Përgatitja e korrespondencës me ofertuesit/konsulentët në koordinim të ngushtë me menaxherin e EMP-së;

- Publikimi i dhënies së kontratës sipas kërkesave të përcaktuara në udhëzuesit e Bankës Botërore.

Eksperti i prokurimit i SAMP-së do të punojë nën mbikëqyrjen e menaxherit të projektit (EMP) dhe drejtorit të programeve të zhvillimit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Eksperti i prokurimit duhet të ketë:

- Diplomë universiteti në ekonomi, inxhinieri, administrim biznesi, ligj ose kualifikim profesional ekuivalent;



- Së paku 8 vjet përvojë profesionale relevante me minimum tre vjet si ekspert/specialist i prokurimit për zbatimin e aktiviteteve të prokurimit të projekteve të financuara nga organizatat ndërkombëtare të zhvillimit, preferohet nga Banka Botërore dhe mundësisht në sektorin social;

- Njohuri dhe eksperiencë e provuar në aspektin organizativ dhe operacional të menaxhimit të projekteve, veçanërisht në projektet e financuara nga Banka Botërore dhe institucione ndërkombëtare financiare të tjera;

- Aftësi shumë të mira të prokurimit;

- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit me shkrim dhe me gojë në gjuhën angleze.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit, SAMP, fton të gjithë konsulentët legjitimë (konsulentë) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion ku të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme (përfshi një kopje të librezës së punës/kopje të kontratave origjinale të mëparshme), për të kryer shërbimin e kërkuar.

Kriteret e shortlistimit janë:

1. Kualifikimet e përgjithshme	30 pikë
2. Eksperienca të ngjashme	50 pikë
3. Aftësia për të kryer shërbimin	20 pikë
TOTALI	100 pikë

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore, për: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA & grante nga huamarrësit e Bankës Botërore* (Udhëzuesi i Konsulencës), version i janarit të 2011-ës.

Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është përzgjedhje sipas konsulencës individuale (IC), në përputhje me procedurën e përcaktuar në udhëzuesit e Bankës Botërore, “Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve të Bankës Botërore (versioni i janarit të vitit 2011).

Konsulenti do të kontraktohet me kohë të plotë pune për periudhën që fillon nga shkurti 2018 dhe vazhdon deri më 31 dhjetor 2018.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00–16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00, të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me e-mail) deri më **21 gusht 2018**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)
Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – kati I

Rruga e Kavajës, nr. 53, AL - 1001, Tirana, Albania

Në vëmendje të znj. Suzana Papadhopulli
e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

**REQUEST FOR EXPRESSION OF
INTEREST
CONSULTING SERVICES
FOR**

**Local procurement expert
Local individual consultant
- Ref. no. SAMP/CS/IC/03-2017-D**

Albania

Social Assistance Modernization Project - (SAMP)

Loan No.: 8141- AL

Project ID No. P122233

The Republic of Albania, has received financing from the World Bank toward the cost of the Social Assistance Modernization Project (SAMP), and intends to apply part of the proceeds for consultant services. The consulting services (“the Services”) include “**Local procurement expert**”

The procurement consultant will be responsible for ensuring that goods and consulting services under the second component of Social Assistance Modernization project (SAMP) are procured in accordance with the Procurement and Consultant Guidelines (January 2011).

The procurement expert will be responsible for:

- Work with concerned technical working groups in the preparation of terms of reference for contracts to be procured mainly under the project component 2, in accordance with various selection methods specified in the procurement plan.

- Assist the concerned technical working groups and evaluation committees in the evaluation of proposal received, on the bases of criteria stipulated in the bidding documents or Request for Proposals.

- Work directly and assist the staff of Health and Social Protection Development Programs



Department and the staff of MHSP, for every procurement issues during the implementation of the project activities.

- Ensure preparation of comprehensive evaluation reports according to the World Bank standard formats and timely transmission of the evaluation reports to the World Bank for review and no objection.

- Establish and maintain efficient procurement and contracting tracking system (noting important approval dates, awards, contract amounts etc.) as well as a proper filing system to ensure quick retrieval of procurement information by the project staff, supervision missions, annual auditors etc.

- Prepare and submit to the manager of the PMT periodic procurement reports describing procurement procedures for implementation of project activities in compliance with the schedule, and identifying procurement issues arising during project implementation and solutions proposed.

- Prepare and publish procurement notifications;

- Prepare Bidding Documents and Requests for Proposal;

- Prepare all necessary documentation for bid opening, clarifications, amendments, evaluations and award of contract;

- Submit draft negotiated contracts to the Bank for prior review contracts

- Prepare and update of Procurement Plans and ensure timely implementation of procurement packages.

- Prepare correspondence with bidders/consultants in close coordination with the Manager of PMT.

- Advertise of contract award as required under applicable World Bank guidelines.

The SAMP procurement expert will work under the supervision of the Project Manager (PMT) and the Director of Health and Social Protection Development Programs. The procurement expert should have:

- University degree in economics, engineering, business administration, law or equivalent professional qualification.

- At least 8 years of relevant professional experience with a minimum three years as a procurement expert/specialist in the implementation of the procurement activities of projects financed by international development

organizations, preferably by the World Bank, and preferably in social sector;

- Proven knowledge and experience in the organizational and operational aspects of project management especially in projects financed by the World Bank and other IFIs.

Very good procurement skills.

Excellent written and oral communication skills in English language.

The Ministry of Health and Social Protection, through the Project Management Team (PMT) now invites eligible local individual consultants (“Consultants”) to indicate their interest in providing the Services. Interested individual Consultants should provide information demonstrating that he/she has the required qualifications and relevant experience (including a copy of Labour Book (*Employment Recording Book*)/or copy of the original signed contracts from the previous assignments), to perform the Services.

The short listing criteria are:

General Qualification	30 points
Relevant Experience	50 points
Capability to carry out the assignment	20 points

TOTAL

100 points

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank’s Guidelines: *Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers* (“Consultant Guidelines”) - January 2011, setting forth the World Bank’s policy on conflict of interest.

The selection method to be applied is **Individual Consultant Selection (IC)**, in accordance with the procedures set out the World Bank’s *Guidelines: Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers* (edition of January 2011).

Consultant is expected to be contracted on a full-time basis during the period commencing February 2018 and continuing through December 31, 2018.

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday.



Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by fax, or by e-mail) by **August 21, 2018**.

**Project Management Team (PMT)
Social Assistance Modernization Project
(SAMP)**

**Ministry of Health and Social Protection –
1-st floor**

**Rruga e Kavajës, nr. 53, AL-1001, Tirana,
Albania**

Att: Suzana Papadhopulli

e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

NJOFTIM

Nr. 5724, datë 9.8.2018

PËR POZICIONIN E LIRË TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton personat e interesuar të aplikojnë për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm në këtë institucion.

10.8.2018

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: I-a.

Personat e interesuar të aplikojnë për këtë pozicion **brenda 20 ditëve pas publikimit**.

Të gjithë të interesuarit duhet të dorëzojnë në institucionin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (me postë apo dorazi) dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë vijon:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Dokument që ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi ose në shkencë ekonomike me diplomë “master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi ose në shkencë ekonomike jashtë vendit dhe ka marrë

një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

Diplomën shoqëruar me listë notash, fotokopje të noterizuara;

Për personat që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, dokumentin e njësimit të diplomës, të shoqëruar edhe me diplomat dhe listën e notave përkatëse, fotokopje të noterizuara.

3. Dokument që ka pasur një përvojë pune në nivel menaxherial dhe drejtues, jo më pak se 10 vjet;

CV, të shoqëruar me librezë pune apo çdo dokument tjetër që vërteton këtë kriter.

(Njohuritë në nivel menaxherial përfshijnë: njohuri në marrëdhënie pune, organizative, drejtuese apo menaxheriale. Kandidati duhet të zotërojë në mënyrë të mjaftueshme aftësi profesionale dhe organizative për të përfaqësuar institucionin në marrëdhënie me palët e treta, si dhe të ketë aftësi personale për të mbajtur të motivuar dhe produktiv personelin e institucionit.)

Të plotësojë kriteret për pajisjen me certifikatë sigurie të nivelit të lartë.

4. Dokument që ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

Kandidati duhet të informojë, gjithashtu, për çështje të tjera të konfliktit të mundshëm të interesit apo të konfliktit në dukje. Ai duhet të shfaqë marrëdhënie mirëbesimi me Komitetin *Ad Hoc* gjatë procesit, i cili mban në konsideratë sjelljet e kandidatit në vlerësimin përfundimtar.

5. Dokument që zotëron shumë mirë gjuhën angleze. Njohuritë e gjuhës angleze do të testohen edhe nëpërmjet një interviste me gojë me kandidatin.

6. Dokument që ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

Do të vlerësohet paraqitja e rekomandimeve pozitive të punës së tyre.

7. Dokument që nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit (kjo mund të shprehet edhe me deklaratë individuale).

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.